

UDC 355.45(497.115-17)

Fisnik Sadiku, MA²²⁶

Besnik Lokaj, MA²²⁷

Fitim Ibrahimimi, MA²²⁸

SITUATA E SIGURISË NË PJESËN VERIORE TË KOSOVËS

БЕЗБЕДНОСНАТА СИТУАЦИЈА ВО СЕВЕРНИОТ ДЕЛ НА КОСОВО

THE SECURITY SITUATION IN THE NORTH PART OF KOSOVO

Abstract

Security in general and human security in particular, are a fundamental elements for the state functioning. In this paper we will discuss for the security in northern part of Kosovo since 1999 until today, and the role of UNMIK, KFOR, EULEX, Kosovo Police and Judiciary in law enforcement. Through this paper we will try to make a separation from political to security aspect.

The northern part was not in effective control of the Government of the Republic of Kosovo for two decades and the Serb minority in that part continues to oppose unanimously integration in Kosovo. Parallel security structures from Serbia, continues to operate in the northern part of the country. Kosovo Police has no respect and

²²⁶ Magjistër në Studime të Sigurisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni, fisniksadiku@gmail.com

²²⁷ Magjistër në Studime të Sigurisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni, besniklokaj@hotmail.com

²²⁸ Magjistër në Studime të Sigurisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni, fitim_ibrahimi@hotmail.com

support; their relations with regional supervisors in the south part of the Ibar and with the judiciary are strained. The northern part has long suffered from a reputation of organized crime where ordinary citizens crouch in fear, have longing for the rule of law, in other words, that part has been flourishing hotbed for smuggling and organized crime. All these are to be addressed in the reminder of this paper.

The methods used in this paper are analytical and research methods, conducted by interviews and comparing printed publications, electronic and scientific works. However, the recommendations and conclusions of this paper are inadequate in some aspects, because our research is skewed towards security issues, and does not consider the political implications, though politics plays a key role in the situation in the northern part of the country.

Key words: *security, parallel structures, organized crime, physical barricades, attacks*

Abstrakti

Siguria në përgjithësi dhe siguria njerëzore në veçanti, janë elementi themelor për funksionimin e një shteti. Në këtë punim do të diskutohet për situatën e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës që nga viti 1999 e deri më sot, si dhe roli i UNMIK-ut, KFOR-it, EULEX-it, Policisë së Kosovës dhe Gjyqësorit në zbatimin e ligjit. Përmes këtij punimi ne do të mundohemi të bëjmë një ndarje nga aspekti politik në atë të sigurisë.

Pjesa veriore nuk ka qenë në kontroll efektiv nga Qeveria e Republikës së Kosovës që dy dekada dhe minoriteti serb në atë pjesë vazhdon të kundërshtoj njëzëri integrimin në Kosovë. Strukturat paralele të sigurisë nga Serbia vazhdojnë të operojnë ende në veri të vendit. Policia e Kosovës nuk gëzon respekt dhe mbështetje;

marrëdhëniet e tyre me eprorët rajonal në jug të Ibrit dhe me gjyqësorin janë të tendosura. Pjesa veriore ka vuajtur gjatë nga reputacioni i një parajse të krimit të organizuar ku qytetarët e zakonshëm struken në frikë, kanë dëshirën e zjarrtë për sundimin e ligjit, me fjalë të tjera ajo pjesë ka qenë çerdhe për lulëzimin e kontrabandës dhe krimit të organizuar. Janë të gjitha këto që do të trajtohen në vazhdim të këtij punimi.

Metodat e përdorura në këtë punim janë metoda analitike dhe kërkimore, duke realizuar intervista dhe krahasuar botime të shkruara, elektronike dhe punime të ndryshme shkencore. Sidoqoftë, rekomandimet dhe konkludimet e këtij punimi janë të pamjaftueshme në disa aspekte, për arsye se hulumtimi jonë anon drejt çështjeve të sigurisë, dhe nuk merr parasysh ndikimet politike, edhe pse politika luan një rol qendror në situatën e krijuar në veri të vendit.

Fjalët kyçe: *siguria, strukturat paralele, krimi i organizuar, barrikatat fizike, sulmet.*

1. Hyrje

Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida të ndryshme politike, ekonomike e të sigurisë së përgjithshme, e në veçanti në pjesën veriore të Kosovës, ku krimi i organizuar, kontrabanda, barrikatat fizike, qarkullimi jo i lirë i qytetarëve shqiptar, janë çështjet më sfiduese për mekanizmat e zbatimit të ligjit.

Krimi i organizuar në kushtet e institucioneve demokratike jo plotësisht të konsoliduara, ka gjetur shtat për tu zhvilluar në masë të madhe në pjesën veriore të Kosovës. Ekzistenca e një sasive shumë të madhe armatimi dhe municioni në duart e popullsisë dhe grupeve kriminale serbe, në një situatë të përshtatshme mund të kthehet në një rrezik të paparashikueshëm për sigurinë e brendshme të shtetit.

Menaxhimi i integruar i kufirit dhe siguria në kufi, përbën një angazhim të veçantë në raport me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi, veprimet politike dhe Sigurinë Kombëtare brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare veçanërisht në

procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, strukturat tjera ndërkombëtare dhe ndërtimin e besimit me shtetet fqinje e më gjerë.²²⁹

Me gjithë shpalljen e pavarësisë, Kosova e sotme është sovraane vetëm në mënyrë të kufizuar dhe është de facto e ndarë në veriun e banuar me serbë dhe jugun e dominuar nga shqiptarët. Dallimet thelbësore në mes të shumicës shqiptare dhe pakicës serb po thellohen edhe më, duke u shndërruar kështu në një “konflikt të ngrirë” të institucionalizuar. Bashkësia ndërkombëtare si “protektor kundër vullnetit” që nga viti 1999 mund të raportojë vetëm për suksese të kufizuara. Misioni i Bashkimit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe pretendimi ambicioz e tij si “roje e demokracisë dhe sundimit të ligjit” në Kosovë do të maten në bazë të asaj, nëse kushtet e jetës për të gjithë kosovarët do të përmirësohen në realitet.²³⁰

Janë të gjitha këto që do të trajtohen në vazhdim të këtij punimi.

2. Situata e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës

Nga këndvështrimi historik, siguria është vlerë fundamentale e marrëdhënieve njerëzore, ndërkaq gjendja e saj është institucionalizuar përmes shfaqjes së shtetit sovran dhe sistemit të shteteve në nivel global.

Siguria është kategori kushtetuese në shtetin juridik, gjë që obligon organet dhe institucionet shtetërore të përmbushin këtë detyrim ndaj qytetarëve, për të cilët siguria është një e drejtë themelore e pa tjetërsueshme. Se sa sot është e mundur të përmbushet ky detyrim kushtetues ndaj qytetarëve dhe në cilin nivel të cilësisë është çështje relative, kur dihet fakti se faktorët sfidues të sigurisë janë gjithnjë në rritje dhe gjithnjë e më shumë është e pa qëndrueshme siguria.²³¹

²²⁹ Republika e Kosovës, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Prishtinë, 2009, f. 8.

²³⁰ Veldran Dzihic, Helmut Kramer, International Policy Analysis, *”Kosova pas pavarësisë”*, 2008, f.1, punim i publikuar në internet.

²³¹ Fatmir Qollakaj, *”Krimi i organizuar si faktor me ndikim në proceset politike – Rasti i veriut të Kosovës”*, punim i publikuar në internet, f. 1.

Siguria dhe pasiguria përkufizohen në lidhje me kërcënimet si ato të brendshme ashtu edhe ato të jashtme, që janë të afta të gjuhëzojnë dhe/ose të dobësojnë strukturat shtetërore, si ato territoriale ashtu edhe ato institucionale dhe regjimet qeveritare.²³²

Nga hulumtimet tona të realizuara, e që kanë të bëjnë me situatën e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës dhe format e kërcënimit jo ushtarake, na bënë të kuptojmë se sa e rrezikuar ka qenë dhe vazhdon të mbetet siguria në fushat e ndryshme të zhvillimit dhe civilizimit bashkëkohor.

Me fjalën rrezikim do t'i quajmë rreziqet e ndryshme potenciale dhe reale të cilat shkaktohen me veprimet e individëve dhe grupeve, të cilat sipas vëllimit, intensitetit, kohës dhe mënyrës së shfaqjes, mund të sjellin ose kanë sjellë pasoja të dëmshme për shoqërinë, me të cilat rrezikohen vlerat themelore të shtetit dhe qytetarëve, ose sjellin çrregullime dhe jo stabilitet në funksionimin e institucioneve vitale shtetërore.²³³

E vërteta për pjesën veriore të Kosovës është se atje mungon rendi dhe ligji, Policia e Kosovës vepron por nuk është e plotfuqishme, mungon funksionimi i Gjyqit sikurse edhe qytetarëve të cilët janë të konfuzuar në mes të ndjenjës së lojalitetit politiko-etnik dhe nevojës për jetë dinjitoze me sundim ligji dhe mirëqenie ekonomike. Po ashtu e vërtetë është që EULEX me vonesë ka arritur që të shtrihet në veri dhe me një mandat limitues të monitorimit, në veri ka mbetur mbase forca e vetme që është dashur që të ndërlihdë Prishtinën e pas pavarësisë me një pjesë të territorit të sajë në veri, por që të njëjtën kohë duke mos hidhëruar Beogradin. E tëra do të ishte më pak komplekse sikur aty të mos ishin edhe aktorët tjerë ndërkombëtar me role dhe qasje të ndryshme dhe jo gjithnjë me strategji dhe pozicion të njëjtë apo të koordinuar që veprojnë të ndarë në disa baza legjislative që sigurojnë mandatin dhe prezencën në veri.²³⁴

²³² Alan Collins, *“Studime bashkëkohore të sigurisë”*, f. 16-17.

²³³ Ramo Maslesha, *“Bazat e Sigurisë”*, Sarajevë/Prishtinë, f. 73.

²³⁴ Ylber Hysa, Amir Haziri, Gynen Venhari, Zyra e Koordinatorit për Strategjinë e Veriut të Kosovës, *“Raport mbi institucionet paralele në veri të Kosovës”*, 2001, f. 5.

Liria e lëvizjes në pjesën veriore është e kufizuar për shqiptarët. Në Paragrafin 1 të Nenit 2 Protokolli 4 i Konventës Evropiane, thuhet se secili që gjendet në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti, ka të drejtë e lëvizjes së lirë dhe të zgjedhjes së lirë të vendbanimit në atë shtet. Ndërsa Neni 3 Protokolli 4 i Konventës Evropiane thotë se, askush nuk mund të jetë i ndjekur qoftë individualisht apo në përmasa kolektive nga territori i shtetit, shtetas i të cilit është dhe askush nuk mund të privohet nga e drejta të hyjë në territorin e shtetit të vet.²³⁵ Në pjesën veriore, jo vetëm që është ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike, por njëkohësisht është bërë dhe bëhet shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për arsye se lëvizja e lirë është e limituar dhe zgjedhja e vendbanimit është pothuajse e pamundur, dhe populli shqiptar, jo vetëm që është ndjekur individualisht, por edhe në përmasa kolektive nga pronat e tyre, shumica prej tyre duke jetuar në një varfëri të skajshme.

Andaj, lidhur me atë se çfarë duhet të bëhet që situata t'i kthehet normalitetit në pjesën veriore të Kosovës, e veçanërisht në pjesën veriore të Mitrovicës, përfaqësuesi i Lagjes së Boshnjakëve, Florent Azemi²³⁶ thotë: “Pika e parë, të ndahet një buxhet i veçantë për fushën e mirëqenies sociale, atë të ndërtimit të shtëpive për banorët shqiptar dhe punësimin. Thjeshtë të kemi një tretman të veçantë apo përparësi në kushte të barabarta në kuadër të ligjit, duke u thirrur në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht në parimin e meritokracisë. Pika e dytë, fuqizimi dhe normalizimi i të gjitha organeve ligjore për zbatimin e ligjit, siç janë policia, në të cilën duhet forcuar hierarkia dhe zinxhiri komandues, prokuroria, gjykatat dhe largimi i menjëhershëm i të gjitha shesheve në veri, duke filluar nga i ashtuquajti “parku i paqes”. Duke u thirrur në kushtetutën dhe Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, numri i punëtorëve në çdo institucion duhet të jetë në harmoni me ligjin, e që në veri shqiptarët përfaqësohen me 1/3 e përfaqësuesve

²³⁵ Lada Sadiković, *“Të Drejtat e Njeriut”*, Sarajevë/Prishtinë, 2006, f. 31-33.

²³⁶ Intervistë me përfaqësuesin e Lagjes së Boshnjakëve Florent Azemi, Mitrovicë, 25.10.2014.

në Kuvend, që do të thotë se 30% e shqiptarëve duhet të jenë në cilësinë e punonjësit në çdo institucion apo organe relevante”.

3. Sulmet ndaj shqiptarëve në veri

Sulmet ndaj popullatës shqiptare që banojnë në pjesën veriore të Kosovës, veçanërisht në veri të Mitrovicës, kanë qenë taktikë e përdorur nga strukturat dhe grupet e organizuara kriminale serbe në atë pjesë, që nga periudha e pas luftës, duke i detyruar ata të lëshojnë pronat e tyre dhe të kalojnë në pjesën jugore të qytetit të Mitrovicës.

Praktika dhe fakte të shumta tregojnë për sulme të tilla, ku si pasojnë shumë shqiptar kanë mbetur të vrarë dhe të plagosur. Një pjesë e rëndësishme e këtij punimi është e bazuar në analizat statistikore të vrasjeve, plagosjeve me armë zjarri dhe lëndimeve trupore pas vitit 1999 në veri të Kosovës. Për më tepër, shihni detajet në tabelë:




Tabela 1: Statistikat e vrasjeve, plagosjeve dhe lëndimeve trupore ndaj popullatës shqiptare në veri të Kosovës, periudha 2000-2014²³⁷

²³⁷ Halit Barani, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Qendra Rajonale në Mitrovicë, 2014, Arkivi.

Bazuar në statistikat e mbledhura nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Qendra Rajonale në Mitrovicë, theksohet se në periudhën e vitit 2000-2014, numri total i banorëve shqiptar të vrarë në pjesës veriore të Kosovës është 31, të plagosur me armë zjarri 144 dhe të lënduar rëndë fizikisht 638.

Në vitin 2013, taktikat e përdorura të strukturave kriminale serbe në sulme ndaj banorëve shqiptarë të pjesës veriore kanë ndryshuar. Në vend të vrasjeve, plagosjeve me armë zjarri dhe lëndimeve direkte fizike, ata kanë realizuar vazhdimisht, pothuajse çdo ditë sulme me granata dore, por pa lëndime në njerëz, në mënyrë që në popullatën shqiptare të ngjallin frikë dhe panik, dhe që të njëjtit më pas të fillojnë të shpërngulen nga pronat e tyre për shkak të pasigurisë së kanosur. Ndërsa për vitin 2014, nuk kemi arritur të marrim statistika zyrtare për arsye se akoma nuk është përfunduar raporti vjetor, me ç'rast është e pamundur që të bëhet rrumbullakimi i shifrave.

3 shkurti i vitit 2000, konsiderohet si masakra më e madhe pas përfundimit të luftës së vitit 1999 në pjesën veriore të Mitrovicës, me ç'rast u vranë 11, plagosën 25, keqtrajtuat fizikisht 93, dëbuan me dhunë nga pronat e tyre mbi 1564 familje shqiptare dhe boshnjake me 11364 banorë. Gjithashtu, trazirat e 17 shkurtit të vitit 2004, morën jetën e 11 qytetarëve shqiptar, plagosjen e 85 të tyre dhe lëndime të rënda trupore 233. Trazirat filluan si shkak i mbytjes së tre fëmijëve shqiptar të fshatit Çabër (pjesa veriore) në lumin Ibër, nga disa persona të panjohur serb.²³⁸

Praktikat e përdorura nga strukturat kriminale serbe, janë praktika të përdorura edhe nga terroristët, për arsye se dhuna terroriste është e drejtuar zakonisht kundër aparatit të caktuar shtetëror ose përfaqësuesve të tij me qëllim të ndikimit në realizmin e interesave të caktuara politike. E njëjta metodë është përdorur edhe në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Shkaktimi i ndjenjës së frikës, pasigurisë dhe mosbesimit tek qytetarët shqiptar, sulmet me granata dore, detyrimet për t'i lëshuar pronat private, si dhe publiciteti dhe tërheqja e vëmendjes e faktorit vendor dhe ndërkombëtar, kanë qenë

²³⁸ Po aty.

disa nga taktikat e përdorura nga grupet e organizuara kriminale serbe. Ato gjithashtu kanë krijuar një goditje të madhe të shqetësimeve psikologjike në popullatën e përgjithshme shqiptare.

Vlen të ceket se një familje shqiptare, në lagjen “Lumbardh”, pjesa veriore e Mitrovicës, që nga data 25.03.1999 e deri më 07.03.2003, është sulmuar mbi trembëdhjetë (13) herë me granata dore, por për fat të mirë askush nuk është lënduar deri në atë kohë.²³⁹

Në të kundërtën, në qoftë se përkthehet në gjuhën shqipe fjala “*terror*”, kjo do të thotë *dhunë* ose *frikë*, ndërsa ai që shkakton dhunën ose frikën mbi një shtresë të caktuar shoqërore automatikisht na jep definicionin e terroristit, për arsye se shkaktori i terrorit është terrorist. Andaj, jo vetëm sulmet fizike, por edhe ato psikike që shkaktojnë dhunë, frikë ose pasiguri në popullatë, janë si pasojë e ushtrimit të terrorit. Nëse e krahasojmë numrin e banorëve shqiptar që nga periudha e pas luftës e deri më sot, ky numër ka pësuar rënie të theksuar për shkak të dhunës së vazhdueshme të ushtruar mbi ta nga grupe të caktuara të interesit dhe strukturat paralele që kanë funksionuar dhe vazhdojnë të funksionojnë në pjesën veriore të Kosovës, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte dhe për shkak të rrethanave politike të krijuara në vend, kontrolli i këtyre grupeve nga ana e Qeverisë së Kosovës është pothuajse i pamundur.

Mënyra e kryerjes së veprave të tyre tregon shkallën e lartë të përgatitjes dhe të realizimit të aksioneve të caktuara, të dirigjuara kryesisht nga punonjës të Qeverisë Serbe. Për ta dëshmuar këtë, pas arrestimit të Veselinoviq, nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX, caqe të caktuara kriminale serbe, në Shtator të vitit 2013, vranë nga një largësi prej 120m, një punonjës të policisë së Eulexit, me shtetësi nga Lituania, gjë që dëshmon edhe për profesionalizmin në kryerjen e akteve të tilla kriminale.

Praktika tjetër tregon se strukturat serbe, për t’i arritur objektivat e tyre kanë përdorur një luftë speciale. Kështu, mund të themi se lufta speciale është një kompleks i masave gjithëpërfshirëse,

²³⁹ Halit Barani, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Qendra Rajonale në Mitrovicë, 2014, Arkivi.

përmbajtësore, planifikuese, organizuese, masa të koordinuara, aktivitete të veprimeve në rrafshin politik, ideologjik, ekonomik, diplomatik, propagando-psikologjik, subversive-terroriste, informative-subversive, në rrafshin ushtarak dhe politik, të cilat ndërmerren në paqe kundër një shteti për arritjen e objektivave strategjike territoriale dhe politike. Është fjala për format e ndryshme të kombinuara, të menduara mirë, të planifikuara në mënyrë sekrete, me të cilat tentohet që edhe më tej të acarohet, të destabilizohet ose të ndryshohet raporti i forcave pothuaj në të gjitha sferat e jetës shoqërore.²⁴⁰

Këtu rol të veçantë kanë luajtur edhe mediat elektronike dhe ato të shkruara. Përshkrimi i akteve të dhunës dhe zënia e titujve, kronikave dhe faqeve të para më këto akte do të thotë se grupet kriminale e kanë arritur qëllimin e tyre. Viktima e këtyre akteve nuk është, apo është rrallë objektivi i aktit, viktima e vërtetë është publiku i cili duke parë njerëzit e terrorizuar, të vrarë, ankthin dhe frikën na sytë e tyre, bëhet viktimë njëlloj si dhe ato.

Objekti i mbrojtjes është qetësia shpirtërore e njeriut dhe rehatia e tij, si parakushte për liritë tjera të tij. Njeriu ndjehet i lirë vetëm atëherë kur nuk frikësohet për ekzistencën e tij, kur nuk i kanoset rreziku, kur ndjehet i sigurt. Domethënia e kësaj veprë ka të bëjë me ndryshimin e gjendjes psikike të njeriut dhe atë prej një gjendje të sigurisë psikike dhe fizike në një gjendje të frikësimit dhe të pa sigurisë së tij. Veprimi i kryerjes është kërcënimi i orientuar kah cenimi i sigurisë së tjetrit. Kërcënimi serioz paraqet atë vepër me të cilën personit tjetër i shkaktohet frikë se ai do të sulmohet fizikisht.²⁴¹

4. Siguria njerëzore në pjesën veriore të Kosovës

Ideja se njerëzit duhet të jenë të sigurt në jetën e tyre të përditshme nuk është as e re dhe as e papritur. Një fokus antropocentrik vazhdon të udhëheqë filozofinë tepër të hershme të liberalizmit. Kjo filozofi vendos në qendër të saj individin dhe përshkruan disa kushte

²⁴⁰ Ramo Maslesha, *"Bazat e Sigurisë"*, Sarajevë/Prishtinë, f. 72.

²⁴¹ Ismail Zejneli, *"E drejta penale – pjesa e posaçme"*, Tetovë, 2007, f. 41.

të nevojshme për të garantuar sigurinë e njerëzve, si liria dhe barazia. Termi duket se i ka fillesat e tij në deklaratat politike të Kombeve të Bashkuara në mesin e viteve '90-të, sidomos në Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të vitit 1994. Në atë dokument “siguria njerëzore” përshkruhet si gjendje në të cilën individët lehtësohen nga traumat që rrethojnë zhvillimin njerëzor, ose këto trauma u mungojnë tërësisht. Së pari, siguria njerëzore nënkupton siguri nga kërcënimet kronike si uria, sëmundjet dhe represioni. Së dyti, ajo nënkupton mbrojtje prej përçarjeve të papritura dhe të dëmshme të modeleve të jetës së përditshme – si në shtëpi, punë ose komunitete.²⁴²

Në Kosovë, koncepti i sigurisë njerëzore thirret në një mënyrë të trefishtë. Para së gjithash, bashkësia ndërkombëtare ka aplikuar sigurinë njerëzore me qëllim të mbajtjes së paqes dhe stabilitetin e brishtë në Kosovë. Për bashkësinë ndërkombëtare, ruajtja e paqes së brishtë bëhet me qëllim të themelimit dhe operacionalizimit të institucioneve paralele serbe. Kjo çon në zbatimin e dytë të sigurisë njerëzore: institucionet paralele pretendojnë se ekzistenca e tyre është e nevojshme për të ofruar sigurinë njerëzore për komunitetin serb në Kosovë. Si pasojë, kjo minon kapacitetin e institucioneve publike të Kosovës për të ushtruar autoritetin ligjor në veri të Kosovës dhe në enklavat e tjera territoriale. Paralelisht me këtë, institucionet e Kosovës e kanë parë qasjen e sigurisë njerëzore si një mjet për të provuar kapacitete institucionale për vetëqeverisje të pavarur për të ofruar siguri gjithëpërfshirëse, mirëqenie, dhe politika të integritit për të gjithë njerëzit në Kosovë, me një theks të veçantë për minoritetet etnike.²⁴³

Në Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan nuk ka sundim të ligjit dhe Komiteti i Helsinkit ka dëgjuar nga shumë qytetarë të këtyre viseve se ata jetojnë në frikë. Pjesëmarrja në barrikada praktikisht është shndërruar në detyrim dhe kjo po i largon

²⁴² Alan Collins, “*Studime Bashkëkohore të Sigurisë*”, f. 129.

²⁴³ Adem Beha, Gezim Visoka, “*Human Security as ‘Ethnic Security’ in Kosovo*”, Human Security Perspectives, Volume 7, 2010, f. 83.

njerëzit nga aktivitetet e tyre të përditshme dhe po e vendos jetën e tyre në rrezik. Përfaqësuesit e moderuar politik dhe organizatat e shoqërisë civile nuk mund të punojnë në veri të Kosovës. Banorët iu kanë ankuar Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut për sulme të shpeshhta fizike (përfshirë këtu edhe vendosjen e mjeteve shpërthyes) ndaj atyre individëve që i kundërvihen politikës së udhëheqësve radikal serb apo që kanë kontakte me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare ose të institucioneve kosovare.²⁴⁴

Koncepti i sigurisë njerëzore përqendrohet në individin (e jo në shtetin) dhe në të drejtat e atij individi për sigurinë personale, liritë themelore, dhe qasje në prosperitet të qëndrueshëm. Në terma etike, siguria njerëzore është si një “sistem” dhe një praktikë sistematike që nxitë dhe mbështetë stabilitetin, sigurinë dhe integrimin progresiv të individëve brenda marrëdhënieve të tyre në shtet, shoqëri dhe rajon. Ndërsa, në terma abstrakte, por të kuptueshme, siguria njerëzore lejon individët që të jetojnë jetën, lirinë, dhe të dyja, lumturinë dhe drejtësinë.

Ndërsa, sa i përket asaj se sa kanë qenë të sigurt banorët shqiptar të pjesës veriore të Kosovës, këtë më së miri e tregon Halit Barani²⁴⁵, nga KMDLNJ, dega në Mitrovicë, i cili thotë se shpeshherë në aksionet vrastare, kërcënuese dhe dëbuese të kriminelëve serb, prezent ishte edhe KFOR-i Francez, ku sipas Z. Berani, ka pasur raste kur ata kanë asistuar në dëbimet me dhunë të shqiptarëve dhe kanë maltretuar kalimtarë të rastit pa ndonjë arsye, si dhe kanë bërë bastisje të panevojshme të shtëpive të shqiptarëve.

²⁴⁴ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, “*Komuniteti Serb në Kosovë*”, 2012, f. 67. Për më tepër, shih (<http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/11/Komuniteti-Serb-ne-Kosove-ALB.pdf>)

²⁴⁵ Halit Barani, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Qendra Rajonale në Mitrovicë, 2014, Arkivi.

4.1 Konflikti etnik

Gjatë gjithë historisë, konfliktet etnike kanë qenë prej kohës një pjesë e politikës ndërkombëtare. Edhe sot, luftërat etnike vazhdojnë të jenë format më të zakonshme të konflikteve të armatosura rreth botës.

Konfliktet etnike përcaktohet si episod i konfliktit të dhunshëm, në të cilat pakicat kombëtare, etnike, fetare dhe të tjera, sfidojnë qeveritë për të kërkuar ndryshime të mëdha lidhur me statusin e tyre.

Konflikti etnik është ndoshta burimi më i rëndësishëm i konflikteve në shumë luftëra që ndodhin tani në të gjithë botën. Grupet etnike janë grupe të mëdha njerëzish të cilët kanë të njëjtat lidhje të gjuhës stërgjyshore, kulturës ose të fesë si dhe një dallueshmëri të përbashkët (individët njëjtësohen me grupin). Megjithëse konfliktet ndërmjet grupeve etnike shpesh kanë natyrë materiale, sidomos për territorin e kontrollin mbi qeverinë, vetë këto konflikte burojnë prej një mospëlqimi ose urrejtje që pjesëtarët e një grupi etnik ndiejnë vazhdimisht për pjesëtarët e një grupi tjetër etnik. Konflikti etnik nuk mbështetet pra mbi çështje të prekshme (në lidhje me atë që bën dikush), por mbi çështje abstrakte (në lidhje me atë çka është dikush).²⁴⁶

Kosova është një shtet i njohur në Evropën Juglindore e cila shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 2008, ndërsa Serbia njih qeverisjen e territorit të Republikës së Kosovës, ajo ende vazhdon të pretendojë atë si “krahinë të vet autonome të Kosovës e Metohisë”. Tensionet afatgjate të rënda etnike ndërmjet popullatës shqiptare dhe serbe në Kosovë lënë atë të ndarë etnikisht, duke rezultuar në dhunë ndër-etnike, duke përfshirë edhe luftën e vitit 1999.

Dhuna ndaj shqiptarëve të Kosovës, jo vetëm gjatë vitit 1999, por edhe nga viti 2000 e deri më sot, i referohet dhunës së motivuar nga urrejtja etnike dhe konflikti etnik. Kjo është zakonisht e lidhur me dhunën politike, dhe shpesh termet janë të këmbyeshme, ose

²⁴⁶ Joshua S. Goldstein, “*Marrëdhënie Ndërkombëtare*”, 2003, f. 214.

njëri është i përdorur si pretekst për tjetrin kur është politikisht e leverdishme. Format e dhunës etnike të ushtruara edhe pas vitit 2000, mund të thuhet lirshëm që kanë karakterin e terrorizmit por të cilat janë të njohura edhe si terrorizëm etnik apo terrorizëm etnikisht i motivuar. Një shembull për ta argumentuar këtë është edhe masakra e 3 shkurtit të vitit 2000, në pjesën veriore të Mitrovicës, të ushtruar ndaj popullatës civile shqiptare, nga strukturat kriminale serbe, të dirigjuara nga Serbia, ku mbetën të vrarë dhe të masakruar 11 persona, të plagosur rëndë 24 dhe 89 prej tyre të lënduar rëndë.²⁴⁷

Megjithatë, edhe ç'është më e rëndësishmja, konflikti etnik nuk është aspak universal në shoqëritë heterogjene etnike, ku në shumë vende grupet etnike bashkëjetojnë në mënyrë paqësore. Gjithashtu, shumë shoqëri heterogjene etnike përjetojnë gjatë periudhat e marrëdhëniet mjaft harmonike etnike para ose pas periudhave të konfliktit. Pse disa vende përjetojnë konflikt etnik dhe të tjerët nuk kanë?

Një implikim i konceptimit tonë të etnicitetit si një pajisje kufizbatuese, është se jo të gjitha dallimet etnike janë mënyra po aq të efektshme për realizimin e anëtarësimit në grup. Në veçanti, është e mundur që disa lloje të identiteteve etnike janë të vështira për t'u zgjedhur se sa të tjerat. Një arsye për këtë është se disa identitete etnike janë vërejtur më lehtë nga anëtarët e grupeve të tjera. Rasti më i qartë i kësaj është rasti i ngjyrës së lëkurës, ose karakteristikat tjera fizike që ndryshojnë dukshëm në mesin e grupeve etnike, me ç'rast kufijtë etnikë në bazë të dallimeve fizike duhet të jenë më të lehta për t'u kuptuar se sa kufijtë në bazë të dallimeve jo të dukshme. Një arsye tjetër pse jo të gjitha ndasitë etnike janë njëlloj rezistent ndaj kalimit është se shpenzimet psikike duke dhënë dikujt identitetin etnik, mund të ndryshoj me natyrën e këtij identiteti. Për shembull, në disa raste duke kaluar nga një grup në tjetrin mund të kërkoj konvertim fetar, ndërsa në të tjerat si origjina dhe grupet e destinimit

²⁴⁷ Halit Barani, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Qendra Rajonale në Mitrovicë, 2014, Arkivi.

kanë të njëjtën fe. Braktisja e identitetit fetar mund të jetë më i kushtueshëm psikologjikisht se sa braktisja e tipareve tjera të identitetit kulturor. Ndërsa, ajo që është brengosëse në Kosovë është se, më shumë se një vit pasi Kosova shpalli pavarësinë, integrimi i pakicës serbe mbetet sfida kryesore, për arsye se entiteti serb që banojnë në pjesën veriore të Kosovës vazhdojnë të refuzojnë zëshëm integrimin në strukturat e shtetit.

Për Beogradin, izolimi i serbëve nga institucionet e Kosovës është një pikë kryesore në politikën e saj të minuar. Një tjetër synim i rëndësishëm është për të frenuar eksodin e serbëve, duke siguruar nevojat e tyre. Beogradi ka kushtuar burime të rëndësishme për këtë qëllim, por me sukses të kufizuar, veçanërisht në veri të Mitrovicës, ku jetojnë shumica e serbëve të Kosovës. Komunitat paralele serbe nuk veprojnë vetëm në një masë të kufizuar dhe kanë qenë kryesisht të paaftë për të plotësuar nevojat e komunitetit serb. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organet ndërkombëtare janë duke ecur përpara me decentralizimin, si mënyrën më të mirë për t'u angazhuar serbët në institucionet e shtetit të ri, dhe duke bindur ata se kanë një të ardhme të mirë.

E gjithë kjo i ka kushtuar shumë Qeverisë së Republikës së Kosovës sa i përket aspektit të sigurisë së brendshme, për arsye se politika e Beogradit dhe strukturat paralele serbe kanë ndikim direkt në sigurinë e brendshme të shtetit, me ç'rast veriu i sajë mbetet ende i izoluar edhe pse është në një shtet të vetëm. E atyre që ju kushtoi më së shumti ishin banorët shqiptar të pjesës veriore të Kosovës, veçanërisht të Mitrovicës, të cilët ishin dhe vazhdojnë të jenë viktima të politikave serbe në Kosovë.

4.2 Strukturat paralele serbe

Strukturat paralele serbe, vazhdojnë të operojnë ende në veri të Kosovës duke cenuar sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Kjo çështje edhe më tej mbetet mjaft shqetësuese, si për sigurinë kombëtare, ashtu edhe për mekanizmat ndërkombëtarë që

operojnë në Kosovë. Për shkak të gjendjes së krijuar politike në vend, kontrolli i këtyre strukturave është i pa mundur nga Prishtina, gjegjësisht nga mekanizmat për zbatimin e ligjit për arsye se këto financohen dhe dirigjohen direkt nga shteti fqinj, Serbia. Ka pasur raste kur xhandarmëria serbe ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës duke i provokuar banorët e fshatrave përreth kufijve me Serbinë, madje në mars të vitit 2012 policia serbe ka arrestuar dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës në pikën kufitare në Merdare.

Strukturat paralele të Serbisë janë aktive në Kosovë, edhe pse marrëveshja e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë parashikon eliminimin e tyre. Përfaqësuesit politik serb në Kosovë ushtrojnë funksionin e tyre nën ombrellën e institucioneve të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht janë të mandatuar nga qeveria serbe që të ushtrojnë funksionin e tyre brenda Kosovës. Në fakt, nga këndvështrimi i këtyre përfaqësuesve, ata janë legalë, njëri nga institucionet kosovare, e tjetri nga ato serbe.²⁴⁸

Në anën tjetër, përfaqësuesi i Lagjes “7 Shtatori” në pjesën veriore të Mitrovicës, Ergin Rexhepi²⁴⁹ thotë se “Asnjë institucion i sigurisë për zbatimin e ligjit në këtë pjesë nuk është në nivelin e duhur. Përderisa serbët që jetojnë në Kosovë marrin paga të dyfishta dhe një shumë enkas që quhet “minimalac”, dhe që sipas emisionit “Insider” të televizionit serb B92, për çdo ditë ndahet shuma prej 864,000€ nga qeveria serbe. Nga ana tjetër, banorëve shqiptar të pjesës veriore të Mitrovicës në të shumtën e rasteve ju ndalet edhe paga sociale nga Ministria e Mirëqenies Sociale e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila është një shumë solide prej 80€”.

Përveç çështjeve infrastrukturore dhe ekonomike në komunat me përfaqësues serb, një nga sfidat më të mëdha për komunat e reja, por edhe për ato ekzistueset, është e natyrës politike. Ekzistenca e strukturave paralele politike dhe administrative, por edhe të atyre të punëve të brendshme dhe të shërbimit të zbulimit, do të shkaktojnë një ballafaqim të pashmangshëm me politikën dhe qeverisjen e

²⁴⁸ Për më tepër, shih (<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=95940>).

²⁴⁹ Intervistë me përfaqësuesin e Lagjes 7 Shtatori, Ergin Rexhepi, 25.10.2014.

autoriteteve të sapo zgjedhura komunale, duke krijuar kështu një tension politik dhe shoqëror.²⁵⁰

Nga ana tjetër, problemi kryesor ose pengesë në luftën kundër krimit të organizuar janë enklavat serbe, ku dora e ligjit dhe e policisë nuk i mbulon si duhet që nga viti 1999. Fatkeqësisht shërbimi sekret serb është duke punuar kundër stabilitetit të Kosovës dhe mbështet strukturat paralele ilegale serbe në Kosovë, të cilat krijojnë situatë jostabile. Aktiviteti ilegal i Serbisë në Kosovë nëpërmjet shërbimit të fshehtë të saj nuk është ndalur edhe pas vendosjes së strukturave ndërkombëtare në Kosovë në vitin 1999. Nga ana tjetër, edhe agjencitë e huaja të shërbimeve sekrete kanë ndjekur gjithë kohën interesat e tyre dhe nuk kanë bashkëpunuar si duhet as brenda bashkësisë ndërkombëtare, por as me institucionet e Kosovës.²⁵¹

4.3 Barrikatat fizike

Barrikatat fizike, të instaluara në pikat kyçe të qarkullimit të qytetarëve si në këmbë, ashtu edhe automjete, të cilat ishin vendosur në vitin 2011 nga serbët lokal të veriut të Kosovës, vazhdojnë të jenë akoma prezente, duke vështirësuar qarkullimin e lirë të qytetarëve dhe duke bërë ndarjen fizike të qytetit të Mitrovicës në dy pjesë (veri-jug). Dy nga shumë barrikatat e vendosura nga banorët lokal serb, janë të vendosura mbi urën kryesore të lumit Ibër, ndërsa tjetra është e vendosur në Lagjen e Boshnjakëve, në veri të qytetit të Mitrovicës.

Ajo që është për t'u habitur këtu, është se në marrëveshjen teknike të arritur ndërmjet delegacionit Kosovar dhe ati Serb, të nënshkruar me datë 19 Prill 2013, për largimin e këtyre barrikadave, nuk solli sukses, por që u “modernizuan” barrikatat e tilla. Me datë

²⁵⁰ KIPRED, *“Decentralizimi në Kosovë II: Sfidat e komunave me shumicë serbe”*, Prishtinë, 2009, f. 5. Për më tepër, shih (http://kipred.org/adv/Cms/documents/15478_Decentralizimi_ne_Kosove_II.pdf)

²⁵¹ Enver Sopjani, *“Roli i enklavave dhe strukturave ilegale serbe në Kosovë”*, punim i publikuar në internet, Prishtinë, 2012, f.15.

18 Qershor 2014, në ora 05:00, është larguar barrikada mbi urën kryesore të lumit Ibër, barrikadë kjo e mbushur me zhavorr dhe gurë e që kishte qëndruar tri vite, ndërsa në po të njëjtën ditë, vetëm disa orë më vonë, një grup prej disa qytetarëve serb, përfshirë këtu edhe kryetarin e komunës së Mitrovicës së Veriut, kanë sjellë një ngarkesë me copa të betonit, me të cilat e kanë ribllokuar urën mbi lumin Ibër, duke vendosur vazo të betonit dhe duke mbjellë pisha mbi këto vazo. Banorët lokal serb, këtë barrikadë e quajnë “parku i paqes”. Me datë 22 Qershor 2014, parku i ashtuquajtur i paqes u shndërrua në eskalim të protestave të paralajmëruara të qeta në këtë ditë. Disa pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe protestuesve u ndanë të lënduar, ndërsa disa vetura të Policisë së Kosovës, EULEX-it dhe qytetarëve u dogjën. E gjithë kjo ndodhi si pasojë e “parkut të paqes”. Përshkallëzimi i protestave të qeta në pjesën Jugore të qytetit, rrit nivelin e pa sigurisë në pjesën Veriore të qytetit, kryesisht në pjesët e banuara me popullatë shqiptare.

Sekretari permanent në të ashtuquajturën Ministri për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, thotë se barrikadat i udhëheqin kryetarët e zgjedhur të komunave në veri të Kosovës, e që kanë legjitimitet dhe janë të zgjedhur në mënyrë legjitime.²⁵²

Siguria njerëzore në pjesën veriore të Kosovës është e brishtë. Shërbimet e sigurimit kanë legjitimitet kushtetues e ligjor për krijimin e mekanizmave efikas për sigurinë njerëzore, por që, për arsye të ndryshme politike, kjo nuk është duke u zbatuar në pjesën veriore të Kosovës. Aksioni i Policisë së Kosovës, në vitin 2011, për rivendosjen e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës dhe futjen nën kontroll të pikave kufitare, nuk sollti rezultate të pritura, por vetëm sa u përkeqësua gjendja akoma. Barrikadat ishin vendosur si shenjë e pakënaqësisë së serbëve lokalë ndaj intervenimit të Policisë së Kosovës për futjen nën kontroll të vendkalimeve kufitare në veriun e vendit.

Siguria njerëzore është e “qendërzuar kah populli”, ajo i vë individët dhe bashkësitë e tyre si pikë kryesore të referimit. Krijimi

²⁵² Shih (<http://www.lajmeshqip.com/kombetare/barikadat-ne-veri-te-kosoves-do-te-qendrojne>).

i një kulture të politikës globale, të bazuar në të drejtat për të gjithë, është kërkesë e domosdoshme për përmirësimin e sigurisë njerëzore.²⁵³

Në atë pjesë të Kosovës, të banuar me shumicë të popullatës serbe, kemi të bëjmë me një pasiguri njerëzore, kombëtare dhe ndërkombëtare, ku lulëzon me të madhe krimi i organizuar dhe kontrabanda.

5. Roli i mekanizmave ndërkombëtar dhe vendor në zbatimin e ligjit

5.1 Roli i UNMIK-ut

Mandati i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është themeluar nga Këshilli i Sigurimit në bazë të rezolutës 1244, në vitin 1999. Misioni ishte mandatuar për të ndihmuar dhe siguruar kushte për një jetë normale dhe paqësore për të gjithë banorët e Kosovës dhe avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Përfaqësuesi Special gjithashtu siguron koordinimin me kreun e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), i cili ka përgjegjësi operative në fushën e sundimit të ligjit. EULEX është vendosur në bazë të rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999), dhe vepron nën autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.²⁵⁴

Në përgjithësi, kosovarët e kanë pranuar UNMIK-un, por kurrë nuk e kanë ndier si të vetin. Ata e shikuan atë si politike, të fshehtë dhe të papërgjegjshme në çfarëdo mënyre ndaj komunitetit lokal. “Ideja e udhëheqjes ndërkombëtare mbi një territor të huaj mund të jetë legjitime vetëm nëse ajo udhëheqje ushtrohet në emër të, ose për të mirën e popullatës lokale”. Nëse mbështetemi në këtë definicion,

²⁵³ Benita Ferrero-Waldner, “*Kuptimi i të Drejtave të Njeriut*”, iniciatore e përpilimit të doracakut për të drejtat e njeriut, përkthyer nga Arta Rama dhe Hajredin Kuçi, Vjenë, 2003, f.3.

²⁵⁴ Shih: (<http://www.unmikonline.org/Pages/about.aspx>).

legjitimiteti i UNMIK-ut është i dyshimtë me të madhe, pjesërisht për shkak të mandatit të imponuar nga lart, por gjithashtu edhe për shkak të mënyrës se si është implementuar. Disa kosovarë madje kanë filluar t'i etiketojnë disa veprime të UNMIK-ut si neo-koloniale.²⁵⁵

Pavarësisht vlerësimeve si “çlirimtarë” pas mbërritjes së tyre në Kosovë në vitin 1999, marrëdhëniet në mes të zyrtarëve të UNMIK-ut dhe popullatës lokale janë bërë gjithnjë e më të tensionuara gjatë viteve. Këto tensione janë reflektuar në rritjen e nivelit të pakënaqësisë nga popullsia në Kosovë lidhur me punën e UNMIK-ut, me përjashtim të shtetit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm Soren Jessen Pettersen, i cili zuri këtë pozitë në mes të Qershorit të vitit 2004 dhe Qershorit të vitit 2006. Ndërkohë që asnjë, ose shumë pak publikime kanë analizuar në thellësi këtë rënie në opinionin publik, disa vëzhgues janë përpjekur të shpjegojnë në mënyrë të përgjithshme “dështimin” e misionit. Një nga publikimet më të mira në këtë aspekt, është ai i Ian King dhe Whit Mason, i titulluar “*Si dështoi bota në Kosovë*”.²⁵⁶ Autorët, të cilët më parë kanë qenë punonjës të UNMIK-ut, argumentojnë se dështimi i UNMIK-ut qëndron në paaftësinë e saj ose mungesa e vullnetit për të ndryshuar kulturën politike kosovare. Duke u ndalur në fushën e sigurisë së vështirë, sidomos sigurinë e personelit, King dhe Mason argumentojnë se UNMIK-u e ka neglizhuar mbretërinë e fuqisë së butë, e cila është jetike në përpjekjet e shtet-ndërtimit.

5.2 Roli i KFOR-it

NATO ka drejtuar një operacion të mbështetjes së paqes në Kosovë që nga qershori i vitit 1999, në mbështetje të përpjekjeve të gjera ndërkombëtare për të ndërtuar paqen dhe stabilitetin në këtë

²⁵⁵ Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, “*Administrimi dhe Qeverisja në Kosovë*”, Prishtinë, 2005, f.6. Për më tepër, shih (http://kipred.org/advCms/documents/1732_administrimi_dhe_qeverisja_ne_kosove.pdf) .

²⁵⁶ Ian King dhe Whit Mason, “*Peace at Any Price: How the World Failed Kosovo*”, 2006, Cornell University Press.

zonë. Sot, rreth 5,600 trupa të udhëhequr nga NATO (KFOR), nga 30 vende të ndryshme (23 anëtare të NATO-s dhe shtatë partnerë të KFOR-it) vazhdojnë të kontribuojnë në ruajtjen e një mjedisi të qetë dhe të sigurt, si dhe lirinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia etnike e origjinës.²⁵⁷ Kjo pasqyron përmirësimin e situatës së sigurisë në tërë territorin e Kosovës, me përjashtim të pjesës veriore të Kosovës. Me fjalë të tjera, nevoja për praninë e KFOR-it dhe rolin e tij duhet të fokusohet vetëm në pjesën veriore përderisa në pjesët tjera të Kosovës çështjet të ndërlidhura me sigurinë, veçanërisht ato të sigurisë publike, duhet të jenë nën autoritetin e Policisë së Kosovës.²⁵⁸

Sipas mandati fillestar, objektivat e KFOR-it ishin:²⁵⁹

- Të pengojë çdo armiqësi dhe kërcënim të krijuar ndaj Kosovës nga Forcat Serbe;
- Të krijojë dhe të mbajë një ambient të sigurt në Kosovë, duke përfshirë sigurinë publike dhe ligjin;
 - Të çmilitarizojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës;
 - Të mbështesë misionet humanitare ndërkombëtare;
 - Të koordinohet dhe mbështesë popullsinë civile ndërkombëtare në Kosovë.

Ndërsa, misioni i KFOR-it sot, është:²⁶⁰

- Të kontribuojë për një ambient të sigurt, duke përfshirë sigurinë publike dhe ligjin;
- Të mbështesë dhe koordinoj misionet humanitare ndërkombëtare dhe praninë civile të tyre në Kosovë;

²⁵⁷ Shih: (<http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/natos-role-in-kosovo.aspx>).

²⁵⁸ Mentor Vrajolli, Pëllumb Kallaba, "Rruga e Kosovës drejt programit të NATO-s: Partneriteti për Paqe (PPP)", Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë, 2012, f. 15.

²⁵⁹ Shih: (<http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/history/kfor-objectives.aspx>).

²⁶⁰ Shih: (<http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/mission.aspx>).

- Të mbështes zhvillimin e një shteti demokratik, stabil, multietnik dhe paqësor;
- Të mbështesë zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

KFOR-i ka luajtur një rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, e në veçanti në pjesën veriore të Mitrovicës. Pavarësisht kritikave të shumta, misioni i përgjithshëm i KFOR-it mund të shihet si një sukses relativ. KFOR-i ka qenë relativisht i suksesshëm në arritjen e qëllimeve përmes aplikimit të taktikave ushtarake jo-tradicionale dhe ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e paqes së qëndrueshme në rajon.

5.3 Roli i EULEX-it

EULEX-i është mision i integruar i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit që funksionon në fushën e drejtësisë, të policisë dhe të doganës. Misioni do t'ju ndihmojë autoriteteve të Kosovës, autoriteteve gjyqësore dhe agjencive për zbatimin e ligjit që të arrijnë përparim drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies. Do ta zhvillojë dhe forcojë edhe më tej një sistem të pavarur dhe shumetnik të drejtësisë si dhe një polici e shërbim doganor shumetnik, duke u siguruar që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrja politike dhe t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane. Misioni, në bashkëpunim të plotë me Programet për Asistencë të Komisionit Evropian, do ta zbatojë mandatin e tij përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. Misioni i mban disa përgjegjësi ekzekutive në fushat siç janë krimi i organizuar, krimet e luftës dhe krimet e rënda financiare. Personeli i drejtë-sisë i EULEX-it është aktiv në gjykatat e të gjitha shkallëve në Kosovë.²⁶¹

Deklarata e Misionit të EULEX-it i përmend gjashtë synime kryesore: do të thotë se, ai do t'ju ndihmojë institucionet, organet e

²⁶¹ Doracak i publikuar në internet, Eulex Kosovo, *“Doracak për sundimin e ligjit”*, (<http://www.eulex-kosovo.eu/docs/info/RoLHandbook-AL.pdf>).

drejtësisë dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë në progresin e tyre drejt:

- Qëndrueshmërisë;
- Llogaridhënies;
- Shumë-etnicitetit;
- Lirisë nga ndërhyrjet politike;
- Zbatimit të standardeve të njohura ndërkombëtarisht, dhe
- Përputhjes me praktikat më të mira evropiane.²⁶²

Qasja e EULEX-it ndaj veriut të vendit konsiston në qasje sistematike duke adresuar ndjeshmërinë e situatës politike dhe pasojat të cilat mund të shkaktohen nga veprimet e ndryshme e që kanë të bëjnë me vënien e rendit dhe ligjit në harmoni me legjislacionin shtetëror të Kosovës.²⁶³

Që nga vendosja e misionit të EULEX-it e deri më sot ka pasur kritika mbi punën e këtij misioni dhe rezultatet e tij. Puna e deri tanishme e EULEX-it nuk ka qenë edhe aq efektive sa duhet. Arsye mund të jetë edhe mos-koordinimi i Komuniteti Ndërkombëtarë dhe ndërmarrja e hapave konkrete në vënien e planeve dhe strategjive të këtij misioni në praktikë.²⁶⁴

EULEX-i që nga momenti i vendosjes ka lënguar nga kontradiktat dhe kufizimet strukturale, shumica e të cilave vazhdojnë edhe sot. Ky mision funksionon mbi një bazë ligjore që në njërin anë ka burim të ashtuquajturin Plani i Ahtisaarit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe në anën tjetër Rezolutën e OKB-së, 1244,

²⁶² EULEX Raporti për Programet 2010, 01 Prill 2010. I disponueshëm në: (<http://www.eulex-kosovo.eu/docs/tracking/EULEX-MMA-ACTIONS-20102904-ALB.pdf>).

²⁶³ Forumi për Siguri, “Zbatimi “politik” i ligjit në Kosovë”, Prishtinë, 2011, f.9. I disponueshëm në (http://www.qkss.org/repository/docs/Zbatimi_politik_i_ligjit_Verzioni_i_Fundit_929018.pdf).

²⁶⁴ Instituti Ballkanik i Politikave, *Sundimi i Ligjit dhe EULEX-i*, Prishtinë, 2001, f.13. I disponueshëm në: (http://policyinstitute.eu/images/uploads/EULEX_and_Rule_of_law_May_2011_Final.pdf).

e cila është neutrale ndaj statusit të Kosovës. Në disa komuna veriore të Kosovës, misioni u vendos nën një ombrellë me status-neutral, duke e ndarë misionin etno-territorialisht. Aparati burokratik i EULEX-it ka qenë shumë i madh dhe kultura e organizatës shumë e mbyllët. Marrëdhëniet në mes funksioneve ekzekutive dhe atyre të ndërtimit të kapaciteteve kanë qenë problematike, duke çuar në ndryshime strukturale dhe mosmarrëveshje që vazhdojnë edhe sot. Pjesa gjyqësore e misionit ka qëndruar përjetësisht me personel të pamjaftueshëm, gjë e cila ka nxitur rezultate të dobëta në ndjekjen penale të krimit të organizuar, korrupsionit dhe të krimeve të luftës.²⁶⁵

5.4 Roli i Policisë së Kosovës

Të gjitha qeverive u janë besuar autorizimet e policisë, në mënyrë që të rregullojë çështjet e shëndetësisë, mbrojtjes sociale, sigurisë dhe moralit, sepse shoqëria kërkon sigurimin e rendit, në mënyrë që të përmbushë në mënyrë efektive nevojat e qytetarëve për siguri dhe nevojat tjera shoqërore. Një aspekt i rëndësishëm i zbatimit të autorizimeve policore në shoqëri është organi për zbatimin e ligjit ose policia. Aktivitetet dhe veprimet e policisë janë të përcaktuara pjesërisht nga lloji i shtetit pjesë e të cilit është ajo.²⁶⁶

Misioni i Policisë së Kosovës është zbatimi i ligjit në mënyrë profesionale, efektive dhe efektive.²⁶⁷ Ndërsa, detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë së Kosovës janë: mbrojtjet, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat; mbrojtjet e drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave; parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe të mbajë rendin dhe sigurinë publike; parandaloj dhe t'i zbuloj

²⁶⁵ Grupi për Studime Juridike dhe Politike, “Eulex-drejt një strategji përfundimtare”, Prishtinë, 20014, f.6. Për më tepër, shih ([http://democratizationpolicy.org/uimages/EULEX%20Exit%20Strategy_DPC-GLPS%20Policy%20Report%20\(04-14\)_ALB.pdf](http://democratizationpolicy.org/uimages/EULEX%20Exit%20Strategy_DPC-GLPS%20Policy%20Report%20(04-14)_ALB.pdf)).

²⁶⁶ Haris Halilović dhe Elmedin Muratbegović, “E Drejta Policore”, Sarajevë/Prishtinë, 2007, f.16-17.

²⁶⁷ Shih: (<http://www.kosovopolic.com/?page=1,12>).

veprat penale dhe kryesit e tyre; hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre; mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion; menaxhoj dhe kontrolloj kufirin shtetëror; ofroj ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe të kryej detyra të tjera të parapara me ligjet në fuqi.²⁶⁸

Që nga Shtatori i vitit 1999-2005, Shërbimi Policor e Kosovës (tani Policia e Kosovës-PK), u ballafaqua me çështje më tepër të arritjes së kuantitetit sesa strategjisë anti-krim. Arsye e tërë kësaj ishte se SHPK-ja nuk kishte strukturë komanduese, pastaj e meta e policisë së UNMIK-ut ishte se pjesa dërmuese nuk e njihte realitetin e krijuar në Kosovë, nuk e njihnin mentalitetin e qytetarëve, kishte zbrazësi totale ligjore, edhe ato ligje që ishin në fuqi konsideroheshin të tejkaluara, kështu që edhe zbulimi i veprave të rënda penale ka mbetur pezull dhe si çështje shumë e ndjeshme.²⁶⁹

Ndër institucionet e mëdha të Kosovës, policia është i vetmi institucion që funksionon në Veri. Katër stacionet e policisë në veri janë kryesisht me personel serbë, por të gjitha këto stacione kanë disa oficerë shqiptarë të cilët kryesisht punojnë në lagjet dhe fshatrat shqiptare. Shefat e policisë serbe nuk e gëzojnë e besimin e vendasve e as të bashkësisë ndërkombëtare dhe të Prishtinës, njëri ndër oficerët i cili ka qenë subjekt i katër ankesave të bëra nga Inspektoriati i Policisë së Kosovës, është parë në shoqërinë e kriminelëve të njohur. Vendasit e shohin policinë si joefikase, të papërvojë dhe të korruptuar, përderisa politikanët serb në Mitrovicë hapur kërkojnë që ish oficerët serbë të emërohen në PK, në mënyrë që, sipas tyre, kjo forcë të përmirësohet.²⁷⁰

Kështu vlen të theksohet se pengesa shumë e madhe për funksionimin e zinxhirit komandues brenda Policisë së Kosovës në veri mbetet si pasojë e mosangazhimit të duhur të EULEX si dhe presionit që vjen prej Beogradit zyrtar mbi pjesëtarët e PK në

²⁶⁸ Republika e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, 2012, f.6.

²⁶⁹ Fatos Haziri, *"E Drejta e Policisë"*, Prishtinë, 2010, f. 54.

²⁷⁰ International Crisis Group, *"Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur"*, Raport për Evropë Nr 204, 2010, f. 23.

Mitrovicë. Strukturat ilegale në veri të Mitrovicës synojnë që PK të jetë joefektive në luftimin e krimit të organizuar dhe trafikimit duke i shtyrë pjesëtarët serb të PK-së që të jenë neutral ndaj statusit dhe duke i kërcënuar që të mos bashkëpunojnë me PK-në në jug.²⁷¹

Megjithatë, është me rëndësi të cekim, se pa marrë parasysh karakterin e renditjes së brendshme në çdo shtet, në plan të brendshëm vend kyç zë çështja e realizimit të sigurisë. Shteti në këtë mënyrë bëhet bartës oficial i sigurisë, i cili i jep legjitimitet policisë si organ ekzekutues e cila mbron pastaj shtetin juridik, demokracinë pluraliste, liritë dhe të drejtat elementare të njeriut. Kur është në pyetje siguria e brendshme, policia ka funksionin kyç. Kjo na tregon, se në kushtet moderne nuk mund të paramendohet shteti demokratik dhe modern pa institucione të organizuara në mënyrë të posaçme, të cilat do të mbrojnë të gjitha vlerat.²⁷²

Para së gjithash nën ndikimin e mediave me seli në Serbi, banorët e veriut të Kosovës i shikojnë me mosbesim institucionet kosovare. Në anën tjetër, forcat policore të Kosovës nuk mund të veprojnë në këtë rajon me kapacitet të plotë dhe aktivitetet e tyre kryesisht reduktohen në regjistrimin e veprave penale siç janë vjedhjet dhe dhuna ndaj banorëve. Autoritetet policore në Mitrovicë i thanë Komitetit të Helsinkit në vjeshtë të vitit 2011 që politika ka ndikim të madh në punën e tyre dhe që qendra e policisë në Prishtinë me kujdes i shmanget reagimeve të fuqishme të forcave të saj policore në mënyrë që të mos vij tek eskalimi i konfliktit.²⁷³

²⁷¹ Forumi për Siguri, “Zbatimi “politik” i ligjit në Kosovë”, Prishtinë, 2011, f.9. I disponueshëm në http://www.qkss.org/repository/docs/Zbatimi_politk_i_ligjit_Verzioni_i_Fundit_929018.pdf.

²⁷² Ramo Maslesha, “Policia dhe Shoqëria”, Sarajevë/Prishtinë, 2008, f. 24.

²⁷³ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, “Komuniteti Serb në Kosovë”, 2012, f. 67. Për më tepër, shih <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/11/Komuniteti-Serb-ne-Kosove-ALB.pdf>.

5.5 Roli i Gjykatave

Gjendja e menjëhershme e pasluftës në Kosovë, në fushën e gjyqësorit, rezultoi me një shkatërrim të gjerë në ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve, në infrastrukturë, teknologji dhe kuadro të kualifikuara, me shumë lëndë të pazgjidhura ndër vite, shkatërrim të dosjeve gjyqësore dhe dokumentacionit të rëndësishëm, problemet e sigurisë në rritje dhe me një gjyqësor ende jo funksional.²⁷⁴

Pushteti Gjyqësor në Republikën e Kosovës është i bazuar në parimin e ndarjes, kontrollit dhe balancimit në mes pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Ushtrimi i pushtetit nga gjykatat bëhet në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë. Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.²⁷⁵

Kompleksi i gjykatës në Mitrovicë ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicës në të cilin para shkurtit 2008 ishin të vendosura gjykata e qarkut e Mitrovicës, gjykata komunale, gjykata për kundërvajtje dhe prokuroria e qarkut ka mbetur e pa qasme për gjyqtarët dhe prokurorët publik lokal dhe personelin ndihmës të tyre që pas ngjarjeve të muajve shkurt-mars 2008. Në këtë kompleks të gjykatës aktualisht është i vendosur personeli i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) – që do të thotë gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it së bashku me personelin e tyre ndihmës vendor (shqiptarë të Kosovës dhe serb të Kosovës) si dhe atë ndërkombëtar të cilët ishin vendosur aty zyrtarisht me 9 dhjetor 2008. Personeli i EULEX-it që është i caktuar për këtë gjykatë aktualisht përbëhet nga dy gjyqtarë penalë, dy prokurorë, dy gjyqtarë civilë dhe tre zyrtarë ligjorë.²⁷⁶

²⁷⁴ Shih (<http://www.gjykatasupreme-ks.org/?cid=1,24>).

²⁷⁵ Ligji për Gjykatat Nr.03/L-199.

²⁷⁶ OSCE Mission in Kosovo, “*Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë*”, 2010, f. 1-2.

Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vendor të cilët më parë punonin në kompleksin e gjykatës në veri të Mitrovicës vazhdojnë punën me kapacitet të kufizuar në gjykatën e qarkut të rivendosur në hapësirat e gjykatës komunale në Vushtrri.²⁷⁷ Në veri të Kosovës nuk ka gjykata komunale, në vend të kësaj, gjyqtarët serbë të Kosovës dëgjojnë rastet civile ku përfshihen shkurorëzimet, trashëgimitë dhe raste të ngjashme, në zyrat apo në apartamentet e tyre. Serbia, në mënyrë shumë publike, riemëron gjyqtarë nën sistemin e vet gjyqësor në Kosovë. Prokurorët në veri janë gjithashtu pjesë e sistemit serb. Por, gjykatësit nuk mund të dëgjojnë rastet penale dhe policia e Kosovës nuk mund të bashkëpunojnë me ta.²⁷⁸

Sistemi juridik në Kosovë në veri të lumit Ibër vepron sipas rregullave të tjera dhe në shumë aspekte pothuajse nuk funksionon fare. Drejtësia penale në Veri është bllokuar nga vendimet politike në Beograd, Bruksel dhe Prishtinë. Gjyqtarët shqiptarë të gjykatës refuzojnë të dëgjojnë këto raste kudo përveç në gjykatën e Mitrovicës, për shkak se qeveria e Kosovës dëshiron të përdorë rastet e mbetura të patrajtuara për të krijuar presion për ri-integrimin e Veriut. Serbët verior refuzojnë të shkojnë në gjykatat e Republikës së Kosovës, dhe kërcënojnë me trazira në qoftë se gjykatësit shqiptarë kthehen në gjykatën e Mitrovicës. Beogradi nuk do të bie dakord me emërimin e asnjë gjyqtari të bërë sipas ligjit të Kosovës dhe do të pranojë vetëm gjyqtarët e vet. Të gjithë pajtohen që të gjykohen nga gjyqtarë ndërkombëtarë, por EULEX nuk ka vendosur staf të mjaftueshëm për të kompensuar mungesën e vendorëve.²⁷⁹

Një tjetër problem serioz lidhur me mungesën e një sistemi plotësisht funksional gjyqësor në rajonin e Mitrovicës, ka të bëjë me skadimin e mundshëm të parashkrimit ligjor për shumë raste penale

²⁷⁷ Po aty, f. 2.

²⁷⁸ International Crisis Group, *"Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur"*, Raport për Evropë Nr 204, 2010, f. 21-22.

²⁷⁹ Po aty, f. 22.

dhe kundërvajtje që kanë ndodhur në Mitrovicë, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq.²⁸⁰

6. Krimi i organizuar në pjesën veriore të Kosovës

Si formë posaçërisht e rrezikshme e manifestimit të krimit trajtohet kriminaliteti i organizuar. Ai cilësohet me disa veçori, si lidhshmëria e përhershme me shumë persona në kryerjen e aktiviteteve kriminale, ekzistimi i një strukture organizative me hierarki dhe pushtet të fuqishëm të udhëheqësit; dominimi i rregullit, rendit, disiplinës, përgjegjësisë së anëtarëve, solidariteti i imponuar, ruajtja e fshehtësisë së veprimit dhe mos zbulimi i organizatës, mostradhtia ndaj udhëheqësit etj.²⁸¹ Mosbindja ndaj këtyre “urdhrave”, apo shkelja e ndonjëres prej tyre nga anëtarët e organizatës, mund të qojë deri në pasoja shumë të rënda, e të cilat mund të jenë: likuidimi fizik, keqtrajtimi fizik dhe mendor, kërcënimet në baza familjare, tortura dhe shantazhe nga më të ndryshmet.

Organizatave kriminale e kanë shefin, organet dhe anëtarët e organizatës apo shoqatës. Mënyra e punës dhe aktiviteti i tyre është mjaft konspirativ dhe mbështetet në parimet e fshehtësisë së plotë, të nënshtrimit dhe përgjegjësisë së ashpër të anëtarëve dhe aktivistëve ndaj shefave dhe udhëheqësve më të lartë. Çdo lëshim, gabim, zbulim, thyerje e rregullave të ruajtjes së fshehtësisë ose moszbatimi i detyrave dhe aksioneve konkrete, ndëshkohet ashpër. Lejimi i depërtimit në strukturën e organizatës, shoqatës a grupit nga ana e personave të paautorizuar, e sidomos të organeve të policisë, zakonisht ndëshkohet me vdekje, me likuidim fizik dhe pa gjurmë të anëtarëve apo personave të ndryshëm të cilët në çfarëdo mënyrë kanë tentuar të infiltrohen ose në çfarëdo mënyrë të futen në gjurmë aktiviteteve kriminale.²⁸²

²⁸⁰ OSCE Mission in Kosovo, “*Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë*”, 2010, f. 6.

²⁸¹ Zeljko Shaqiq, “*Organizirani kriminalitet u Hrvatskoj*”, Zagreb, 1997, f.1-5.

²⁸² Ragip Halili, “*Kriminologjia*”, Prishtinë, 2008, f.142.

Krimi i organizuar është problem i ndërlikuar dhe i rrezikshëm shoqëror edhe në shtetet më të zhvilluara të cilat kanë probleme teknike, organizative në zbulimin dhe luftimin e këtij krimi. Kosova e cila ka dalë e shkatërruar nga lufta, në procesin e tranzicionit, nuk ka arritur të krijojë kushtet elementare për luftimin e të ashtuquajturit kriminalitet klasik. Derisa shtetet më të zhvilluara në botë, por edhe ato në tranzicion, janë duke u organizuar për zbulimin dhe luftimin e saj, Kosova është e rrezikuar me krimin e organizuar, për zbulimin e së cilit ka për detyrë faktori ndërkombëtar ²⁸³dhe ai vendor.

Krimi i organizuar është një fenomen, i cili ka lindur si rrjedhojë e kushteve sociale-ekonomike, atyre historike si dhe të traditës. Pavarësisht përhapjes së tij ndërkombëtare, krimi i organizuar ka ngjyrën dhe veçoritë e tij nacionale, mbi bazën e të cilave identifikohet përkatësia, kushtet e lindjes dhe zhvillimit të tij, si dhe korrelacioni me korrupsionin. Veçori e krimit të organizuar është edhe shfrytëzimi i çdo mundësie, si krizat politike-ekonomike, ashtu edhe situatat favorizuese për të zgjeruar perandorinë e vet.²⁸⁴

Reputacioni për mungesë të ligjit është vetëm pjesërisht i merituar. Veriu i mbajtur nga serbët është rreth gjysma e territorit të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë, por përbën vetëm rreth një të pestën e popullsisë së saj. Ajo është përgjegjëse për më shumë se një të katërtën e arrestimeve për vjedhje dhe për më shumë se një të tretën e arrestimeve për sulme, pothuajse të gjitha për shkak të Veriut të Mitrovicës, ku 22.000 banorët që jetojnë në këtë pjesë përbëjnë më pak se 6 për qind të popullsisë, por janë përgjegjës për 18 për qind të rasteve të krimit dhe 25 për qind të rasteve të krimeve të dhunshme. Me një minoritet të konsiderueshëm shqiptar dhe boshnjak, shënohen edhe krime sporadike ndëretnike.²⁸⁵

²⁸³ Vesel Latifi, *“Kriminalistika”*, Prishtinë, 2009, f. 195.

²⁸⁴ Ismail Zejneli, *“Kriminaliteti i Organizuar, aspekte juridike”*, Tetovë, 2009, f. 69-70.

²⁸⁵ International Crisis Group, *“Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur”*, Raport për Evropë Nr 204, 2010, f. 21.

Situata politike, ekonomike dhe e sigurisë, e krijuar në pjesën veriore të Kosovës, që nga periudha e pas luftës e deri më sot, është duke ju konvnuar me të madhe grupeve të organizuara kriminale që operojnë në atë pjesë. Mungesa e zbatimit të ligjit, mos funksionimi i rregullt i Policisë së Kosovës, mos efikasiteti i mekanizmave ndërkombëtarë që janë të thirrur për zbatimin e ligjit në atë pjesë, u mundëson grupeve të organizuara kriminale që të shtrijnë aktivitetin e tyre jo vetëm në pjesën veriore, por edhe në të gjithë vendin. Andaj, jo gjithherë siç pretendojnë strukturat serbe se çështja e veriut është çështje “nacionaliste” dhe “patriotike”, ne mendojmë se veriu i Kosovës është një çerdhe për lulëzimin e krimit të organizuar dhe kontrabandës, dhe, në mënyrë që kjo “çerdhe” atyre mos t’u prishet, ata thirren në “nacionalizëm”, dhe kundërshtojnë në mënyra të ndryshme, qofshin edhe ato me protesta, barrikada, sulme dhe likuidime fizike, shtrirjen e sundimit të ligjit.

Përfundim

Gjatë tërë hulumtimit që kemi bërë lidhur me punimin në fjalë, ne kemi ardhur në përfundim se pika e parë që duhet të kihet konsideratë në përmirësimin e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, është ndryshimi i strategjisë ndaj qasjes me minoritetin serb, e veçanërisht në pjesën veriore nga faktori ndërkombëtar dhe vendor. Edhe pse pakicat-minoritetet përkrahen në një mënyrë apo tjetrën nga faktori ndërkombëtar dhe vendor, minoriteti serb vazhdon të mbetet pjesa më e “përkëdhelur” në vend, gjë që edhe ju ka konvnuar që pas përfundimit të luftës së vitit 1999. Serbët këtë “mundësi” e kanë shfrytëzuar duke arritur qëllimet e tyre politike, ideologjike dhe nacionaliste. Mendojmë që kjo qasje duhet të ndryshohet, dhe që shqiptarët e pjesës veriore të Kosovës të kenë një trajtim më të veçantë nga ana e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Pika e dytë, që gjendja të normalizohet në atë pjesë, mendojmë se duhet të bëhet më shumë lidhur me luftën kundër krimit të

organizuar dhe rikthimin e plotë të sundimit të rendit, ligjit dhe kontrollit kushtetues në atë pjesë, duke pasur parasysh se krimi i organizuar është ai që i mban “gjallë” serbët e pjesës veriore të Kosovës. Një vazhdimësi e aksioneve policore do të ishte e nevojshme për shuarjen e të gjitha lëvizjeve ilegale të cilat veprojnë në veri të Kosovës, të cilat në vazhdimësi e sfidojnë sigurinë njerëzore dhe institucionale dhe krijojnë një imazh jo të mirë të Republikës së Kosovës në sferën ndërkombëtare.

Pika e tretë, të gjithë ata që kanë kryer krime, sulme fizike, spastrime etnike dhe dëbime me dhunë nga pronat popullsinë shqiptare, do duhej të silleshin para drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar, e jo të vazhdojnë aktivitetet e tyre lirshëm.

Dhe krejt në fund, mendojmë se përcaktimi i interesave kombëtare për garantimin e sigurisë së vendit janë vendimtare për arsye se interesat kombëtare dhe shtrirja kohore e realizimit të tyre janë të lidhura organikisht me sigurinë.

Conclusion

Throughout the research that we have done, we have come to the conclusion that the first point that need to be in consideration to improve security in the northern part of Kosovo, is a change of strategy to approach the Serb minority, especially in the northern part from the international and local elements. Although minorities are supported in one way or another by international and local elements, Serb minority remains most “caress” part in the country, which has suited them well after the end of war in 1999. Serbs have used this “opportunity” to achieve their political, ideological and nationalistic goals. We believe that this approach should be changed, and that Albanians in northern part of Kosovo to have a special treatment by institutions of the Government of the Republic of Kosovo.

Second point, that situation should be normalized in that part, we believe that there should be more fighting organized crime and restoring full rule of law, order and constitutional control in that

area, given that organized crime is who keeps “alive” Serbs in northern part of Kosovo. A continuation of police actions would be necessary for shutting down all illegal movements operating in north of Kosovo, which continuously outface human and institutional security and create a bad image of the Republic of Kosovo in the international sphere.

Third point, all those who have committed crimes against Albanian population, assaults, ethnic cleaning and forcible evictions from properties, should be brought to justice and get the punishment they deserve, and not to continue their activities freely.

And in the end, we think that the definitions of national interest to ensure the country’s security are crucial because national interests and deadlines for their realization are organically linked with safety.

Bibliografia

Literatura bazë:

1. Alan Collins, “*Studime bashkëkohore të sigurisë*”.
2. Benita Ferrero-Waldner, “*Kuptimi i të Drejtave të Njeriut*”, Vjenë, 2003.
3. Enver Sopjani, “*Roli i enklavave dhe strukturave ilegale serbe në Kosovë*”, punim i publikuar në internet, Prishtinë, 2012.
4. Fatos Haziri, “*E Drejta e Policisë*”, Prishtinë, 2010.
5. Fatmir Qollakaj, “*Krimi i organizuar si faktor me ndikim në proceset politike – Rasti i veriut të Kosovës*”, punim i publikuar në internet.
6. Haris Halilović dhe Elmedin Muratbegović, “*E Drejta Policore*”, Sarajevë/Prishtinë, 2007.
7. Ismail Zejneli, “*E drejta penale – pjesa e posaçme*”, Tetovë, 2007.
8. Ismail Zejneli, “*Kriminaliteti i Organizuar, aspekte juridike*”, Tetovë, 2009.

9. Ian King dhe Whit Mason, *“Peace at Any Price: How the World Failed Kosovo”*, 2006, Cornell University Press.
10. Joshua S. Goldstein, *“Marrëdhënie Ndërkombëtare”*, 2003.
11. Lada Sadiković, *“Të Drejtat e Njeriut”*, Sarajevë/Prishtinë, 2006.
12. Ragip Halili, *Kriminologjia*, Prishtinë, 2008.
13. Ramo Maslesha, *“Bazat e Sigurisë”*, Sarajevë/Prishtinë.
14. Ramo Maslesha, *“Policia dhe Shoqëria”*, Sarajevë/Prishtinë, 2008.
15. Vesel Latifi, *“Kriminalistika”*, Prishtinë, 2009.
16. Veldran Dzihic, Helmut Kramer, International Policy Analysis, *“Kosova pa spavarësisë”*, 2008.
17. Zeljko Šačić, *“Organizirani kriminalitet u Hrvatskoj”*, Zagreb, 1997.

Punime dhe publikime:

1. Republika e Kosovës, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Prishtinë, 2009.
2. Ylber Hysa, Amir Haziri, Gynen Venhari, Zyra e Koordinatorit për Strategjinë e Veriut të Kosovës, *“Raport mbi institucionet paralele në veri të Kosovës”*, 2001.
3. Adem Beha, Gezim Visoka, *“Human Security as ‘Ethnic Security’ in Kosovo”*, Human Security Perspectives, Volume 7, 2010.
4. Mentor Vrajolli, Pëllumb Kallaba, “Rruga e Kosovës drejt programit të NATO-s: Partneriteti për Paqe (PPP)”, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Prishtinë, 2012.
5. KIPRED, *“Decentralizimi në Kosovë II: Sfidat e komunave shumicë serbe”*, Prishtinë, 2009.
6. Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, *“Administrimi dhe Qeverisja në Kosovë”*, Prishtinë, 2005.
7. Doracak i publikuar në internet, Eulex Kosovo, *“Doracak për sundimin e ligjit”*.

8. EULEX Raporti për Programet 2010, 01 Prill 2010.
9. Forumi për Siguri, *“Zbatimi “politik” i ligjit në Kosovë”*, Prishtinë, 2011.
10. Instituti Ballkanik i Politikave, *Sundimi i Ligjit dhe EULEX-i*, Prishtinë, 2001.
11. Grupi për Studime Juridike dhe Politike, *“Eulex-drejt një strategjie përfundimtare”*, Prishtinë, 2014.
12. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, *“Komuniteti Serb në Kosovë”*, 2012.
13. OSCE Mission in Kosovo, *“Sistemi Gjyqësor në Mitrovicë”*, 2010.
14. International Crisis Group, *“Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavaru”*, Raport për Evropë Nr 204, 2010.

Intervista dhe legjislacione:

1. Arkivi i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Qendra Rajonale në Mitrovicë, Halit Barani, Mitrovicë, 2014.
2. Intervistë me përfaqësuesin e Lagjes së Boshnjakëve Florent Azemi, Mitrovicë.
3. Intervistë me përfaqësuesin e Lagjes 7 Shtatori, Ergon Rexhepi.
4. Republika e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, 2012.
5. Ligji për Gjykatat Nr.03/L-199.

Vegëza nga interneti:

1. <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=95940>
2. <http://www.lajmeshqip.com/kombetare/barikadat-ne-veri-te-kosoves-do-te-qendrojne>
3. <http://www.unmikonline.org/Pages/about.aspx>

4. <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/natos-role-in-kosovo.aspx>
5. <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/history/kfor-objectives.aspx>
6. <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/mission.aspx>
7. <http://www.kosovopolice.com/?page=1,12>
8. <http://www.gjykatasupreme-ks.org/?cid=1,24>